



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE  
SKENDERAJ  
01-060/01-0049500/24  
Data 22.10.2024



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

## ***T H Ē R R E T***

**Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 30.10.2024, (ditë e mërkure), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit**

**Mbledhja do të ketë këtë:**  
**REND DITE**


1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i raportit financiar i realizimit të buxhetit komunal janar-shtator 2024, me Nr.04-052/01-0048205/24, i datës 10.10.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z.Ismet Aliu**);
5. Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga zjarret, era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Korrik-Shtator 2024, me Nr.09-325/04-0048367/24, i datës 11.10.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z.Alban Shala**);
6. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.



**KRYESUESJA E KUVENDIT**  
znj. Adelina Spahiu



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ, i datës 25.09.2024, ora 10:00.

**Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit Komunal të Skenderajt për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027, me Nr.04-400/01-0042674/24, të datës 30.08.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
5. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshmet të personit fizik Naim Vojvoda, me Nr.02-463/01-0042061/24, të datës 27.08.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
6. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshmet të personave fizik Faik Vojvoda dhe Sadete Vojvoda, (bashkëpronësi), me Nr.02-463/01-0042070/24, të datës 27.08.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
7. Propozim-vendim për miratimin e përfundimtar të ofertës nga Shprehja e Interesit, për marrjen në shfrytëzim afatgjatë (99), pronën e paluajtshme të Komunës me sipërfaqe prej 3000m<sup>2</sup>, ofertuesit personit juridik "Ismet Commerce" NTSH, me Nr.01-463/01-003936/24, të datës 14.08.2024, (Raporton anëtar i komisionit);
8. Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar me Nr.09-400/01-0043919, të datës 06.09.2024, i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Janar-Qershor 2024, me Nr.02-400/01-0043973/24, i datës 09.09.2024, (Raporton drejtori i DSHP-së, **z. Alban Shala**);
9. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

**Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:** I nderuar kryetar i komunës Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 27 anëtar, mungon me arsye Ragip Durmishi, Osman Smajli, Abdulla Gashi, dhe Ervina Vojvoda.

Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Afrim Kabashi-NSD:** Faleminderit kryesues, propozoj që ne seancën e sotshme të jete edhe një pike shtese. Ne baze të të ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Udhëzimi administrativ (MAPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme, dhe ne baze të kësaj është bere formimi i komitetet për komunitete dhe është miratuar nga ky kuvend. Mandati i anëtareve të komitetit për komunitete është katër vjeçar i njëjtë me anëtarët e kuvendit. Andaj të nderuar koleg dua t'ju njoftoj që ky komitet nuk po funksionon dhe cilat janë masat që duhet ti ndërmarr kryetari dhe ti kryesues lidhur me këtë çështje?

**Kryesuesja:** Afrim me ndryshimin e ligjit të pagave nuk i kanë bërë përfshirjen në pagesa për anëtarët e komitetit për komunitete dhe komitetet tjera, dhe nuk kemi drejt me formua komitete tjera. E kemi dërgua një shkresë përmes personelit në ministri dhe ministria nuk i pagunë komitetet për komunitete dhe komitetet tjera konsultative.

Dikush tjetër nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (6) kundër dhe (2) abstenim, Miratohet rendi i ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim për Ekstrakt të procesverbalit Konstatojmë me (27) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit Komunal të Skenderajt për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027, Nr.04-400/01-0042674/24, dt. 30.08.2024, (Raporton);

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit Komunal të Skenderajt për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027, është një dokument i hartuar nga ekzekutivi për vitin 2025 dhe parashikimet që do të pësojnë ndryshime gjatë dy viteve në vijim. Si dokument i tillë është dorëzuar në afatin kohorë me datën 30.08.2024 ashtu qysh e parasheh ligji, kryesuesja e ka pas dokumentin në shqyrtim me anëtarët e kuvendit e ka mbajtur një dëgjim buxhetor. Ky buxhet do të financohet nga grandet e përhershme si; Grandi i përgjithshëm, grandi i arsimit, grandi për shëndetësi, transferi i shërbimeve rezidenciale dhe të hyrat vetanake. Është i shpërndarë në 5 kategori ekonomike si: Paga dhe shtesa me 55.43%, Mallra dhe shërbime me 14.32%, Shpenzime Komunale me 1.45%, Subvencione dhe transfere me 5.77%, dhe Shpenzimet kapitale me 23.03%. Në sektorët e Komunës më këtë buxhet 2025 janë të lejuar të financohen 1362 pozita duke përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit Komunal. Dhe në fund e keni listën e projekteve kapitale për tri vite në vijim, materialin e keni pas me kohe, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Hysni Mehani-LVV:** Fjala përshëndetëse, Ky është viti i fundit i këtij mandati dhe po dua me ua kujtua një prej premtimeve kryesore që e keni bërë gjatë fushatës. Video gjatë premtimeve të projekteve krahas adresimit të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve si dhe orientimi për zhvillim socio ekonomik do të realizojmë këto projekte Kompleksin e Banesave për Familjet e Dëshmorëve.....Pra keni premtuar se do ta realizoni Kompleksin e Banesave për Familjet e Dëshmorëve, pra kompleksin UÇK. Po hyni në vitin e fundit të mandatit tuaj dhe ky është buxheti i fundit që do të mund t'i realizoni premtimet tuaja. Keni nda 100 mijë euro për shkronjën Ç gjatë vitit 2025 ndërsa fillimin e shkronjës K e keni shtyrë për vitin 2027. D.m.th. i keni mashtrua kategorinë ma të ndjeshme të këtij qyteti, familjet e dëshmorëve. Për 25 vjet nuk keni mujt me e ndërtuar një kompleks të premtuar për familjet e dëshmorëve, e me qasjen tuaj nuk do të mund ta ndërtoni as edhe për 35 vjet. Përderisa komplekset tuaja private banesore po vlojnë, u stërm bush qyteti. Ju keni premtuar familjeve të dëshmorëve që do t'i ndani banesat e shkronjës U me 18 qershor, sot jemi me 25 shtator. Dhe mos harroni gjatë kësaj kohe keni nënshkruar kontrata në vlerë mbi 25 milionë euro, porse nuk e keni para prioritare t'i realizoni projektet në fjalë. E përderisa nuk keni pas mjete për projektet e sipërpërmendura, keni projektuar projekt si "smart city" - "ndërtimi i fshatit Antik"- "ndërtimi i këndit të lojërave anti-vandalizëm". Analizojeni çfarë buxheti i specifik. Shumë kreativ jeni për besë. Projekti 7 smart city, Projekti 8 fshati antik, Projekti 9 Ndërtimi i këndit të lojërave anti-vandalizëm, Ky kombinim fatal, imagjino kur ja shtojna projektin 5 dron 6 mijë euro. Keni premtuar edhe Subqendra, disa janë shlyer nga lista e

premtimeve e disa vështirë se do realizohen. Me shumë gjasë nuk do të realizohet asnjë. Ose maksimalisht një edhe ajo falë qeverisë qendrore.

Ju që e keni shkatërruar çdo objekt të vjetër tash po doni me ndertu fshat antik. Ju që edeh vallen Okarina e ndaluar sepse konsideruat që humbeni vota. Çka keni mëndu me këndin e lojërave anti-vandalizëm? Sa % e qytetarëve të Skenderajt i konsideroni vandalë që paska lind nevoja me e ndertu një kënd të lojërave anti-vandalizëm, apo po ju keqkuptojmë se në fakt ju jeni tu e ndertu për veti e na po ju keqkuptojmë? Nëse i keni për vete dakord. Me takat participoj edhe unë, veç shkoni vandalizmin tuaj shfryjeni në qatë kënd të lojërave. Ama nëse i keni për qytetarët ju kisha lut që me i ndërro emërtimet parasë me i dërgua në ministri e institucionet e nivelit qendror, ku shkojnë për miratim.

Ky "Droni me pajisje përcjellëse"? që e kemi përmendur edhe njëherë që po kushton 6 mijë a është i tipit Bajraktar apo çfarë lloji, si dhe a e keni trajnuar të personelin për përdorimin e tij? Meqenëse me punë dhe projekte keni dështuar, s'keni ba bash kurrigjë, prej asaj që keni premtuar, duhet me provua me subvencione me i marrë votat. Dikujt një spërkatëse gruri, dikujt najë kotec me pula. Por kështu nuk ka zhvillim, sepse qëllimi në thelb nuk është zhvillimi.

Projekte të mëdha jo se jo, bile pula e koteca.

Shihni ndryshimet të subvencionet për çka u.d. kryetari ose drejtori besoj do të japin sqarime.

1.Subvencionet në Zyrën e Kryetarit në buxhetin e vitit 2024 ishin rreth 28 mijë euro, ndërsa në buxhetin që keni propozuar për vitin 2025 janë paraparë rreth 75 mijë euro.

2.Tek Subvencionet e Drejtorisë së Administratës gjatë vitit 2024 janë paraparë 10 mijë euro, të cilat janë buxhetuar për Çështje Gjinore. Sipas logjikës, këto mjete janë paraparë për mbështetjen e organizatave që promovojnë Barazinë Gjinore. Ndërsa për vitin 2025, keni vendosur që kjo drejtori të ketë zero buxhet për subvencione. A mendoni se më nuk ka nevojë për mbështetjen e promovimit të të drejtave të grave apo për çfarë arsye është vendosur që kjo drejtori të ketë zero buxhet për subvencione?

3. Është interesant nëse analizojmë edhe Subvencionet në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik, ku gjatë vitit 2024 janë buxhetuar 150 mijë euro, ndërsa për vitin 2025 keni paraparë vetëm 80 mijë euro. Ndërkohë, në rastin e Drejtorisë së Bujqësisë, gjatë vitit 2024 janë paraparë rreth 280 mijë euro, kurse për vitin 2025 keni paraparë 360 mijë euro.

Me e përkthye popullorçe, ua keni marrë 10 mijë eurot për barazi gjinore se nuk ka vote aty, i keni marrë edhe 70 mijë euro te zhvillimi ekonomik e për rini se nuk është rendi që bani zhvillim ekonomik ju e as që përkrahni rini, dhe i keni dërguar te Drejtorja e Bujqësisë e cila po akuzohet edhe nga militantet tuaj për dallavere dhe është nënhetime nga policia e prokuroria.

I keni mbledhur aty me shpresën që mundeni me e mbledhë për mos me thane me ble najë vote. LVV nuk ka votë për këtë buxhete i cili qellim të vetit e ka tenderin dhe krijimin sa ma shume tenderëve për të mos e kryer as një punë pra merret vetëm përqindja e tenderit. Jemi kundër këtij buxheti duke mos dashur me i përmend edhe shumë projekte të cilat ju po e përfundoni mandatin e nuk keni bë bash asgjë që projekti me i vlershëm është Kompleksin e Banesave për Familjet e Dëshmorëve, që nuk e di qysh keni me pas fytyrë me ju dal njerëzve përpara.

**Afrim Kabashi-NSD:** Fjala përshëndetëse, në këtë pike nuk do te zgjerohem pasi qe ne takimin e parapare ne rregullore gjate konsultimeve ne dëgjimin buxhetor e drafte buxhetit te komunës Skenderajt për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026/27 Kam paraqite vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet, e te cilat besoj qe nuk do te hasin ne vend te shurdhër nga ana e Ekzekutivit. Sot ne këtë seancë kam disa pyetje sqaruese nga drejtori për buxhet Ismet Aliu; Drejtor a ka mundësi te njoftohemi konkretisht tek emërtimi i projekteve tek nr. rendor 6 emërtimi Bashkëfinancim, për cilin projekt është fjala. Për Drejtorin e Bujqësisë; Buxheti i planifikuar për

vitin 2025 ne kategorinë e subvencioneve dhe transferove prej 360,000.00 €, a mund te dimë konkretisht çka keni planifikuar, ne cilat projekte mendoni ti realizoni, dhe perse është rrite buxheti ne kategorinë e mallrave dhe shërbimeve qe shume ne vlerën e 36,545.00 euro, ne krahasim me vitet e kaluara si p.sh ne vitin 2022 ka qene 15.000.00€, pse është kjo rritje, a keni ndonjë arsye apo për çka është fjala.? Për Drejtorin e Urbanizmit; Ndriçimi publik ne fshatra i cili ka filluar te realizohet, a do te jete i shtrinë ne rrugët qe përfshihen lagjet, apo vetëm ne rrugët kryesore pasi qe ne baze te punëve qe po behën teren po shifet ndriçimi publik do te jete i përfshire vetëm ne rrugët kryesore? Këtë buxhet do ta votoj për arsye së qytetaret që me kanë votua, me kanë dërguar sms që me përkrah këtë buxhet, së për hire të juaj që keni përfundua ndonjë projekt nuk e kisha votua.

**Miradije Buliqi-PDK:** Fjala përshëndetëse, drejtor në dëgjimin publik për buxhet e kam cek, po e përsëris prapë në seancë, Projekti i rrjetit të kanalizimit, si dhe zgjerimi i stratit të lumit në fsh.Qubrel kur pritet të filloj, a keni ndonjë plan? Si dhe ndriçimi publik a po vazhdon neper BL, dhe kur pritet me përfundua, duke e pas parasysh koston e projektit?

**Mentor Mehmeti-PDK:** Fjala përshëndetës, e dëgjova buxhetin, unë me shumë jam për smart citi, për mos me kanë qyteti i munguar, së shume kush kur po vjen me vizitua, dhe kam insistua disa herë që me pas qerekod neper vende historike neper varreza neper përmendore, për arsye se kur të vinë personat për herë të parë me pas njohuri për atë vend, dhe besoj qe aj smart citi ka me na sjell edhe një zhvillim shume me të madh sepse kemi shume vende historike dhe fatkeqësisht nuk po dina me ja transmetua ne vende ku nuk ka ciceron. Buxheti është i qytetarëve është edhe pjesë e jona po nuk është diçka hajt të krenohem se kemi shume, na këna pak, po me qeto pak këna bë shume.

**Naser Bajraktari-IDEAL:** Fjala përshëndetëse, pyetje për Lumin Klina që deri diku e keni punua aty ku nuk ka pas shpija dhe jeni dal përmbi Kuqic, po çka doni me bë me pjesën ku vjen kanalizimi prej Kuqice sepse aty është bllokua edhe kundërmon shumë ere e keqe e kanalizimit, a keni planifikua diçka apo vetëm keni me qua bagerin qysh e keni qua që tri vite? Për drejtorin e bujqësisë, unë e përgëzoj drejtorin që e ka arrite këtë shume të pareve me nda, po kisha pas qef me ditë saktë, çka doni me punua me ato apo doni mi gra si këto tri vite kështu pa kurrfarë perspektive?

**Besart Rrecaj-PDK:** Fjala përshëndetëse, sa i përket buxhetit e dëgjuam drejtorin, në parim unë si asamblist e përkrahi, po e kamë një pyetje-kërkesë, edhe për drejtorin po edhe për kryetarin, masi jam punëtorë i arsimit, tash punëtorët e arsimit janë tu i realizua disa drejta, fatkeqësisht përmes gjykatës dhe përmbaruesve, sa i përket pagesave për shujta dhe inflacion, a kish qenë në rregull drejtor që në buxhetin e vitit 2025 me u parapa një linjë e caktuar buxhetore për këtë çështje, që mos me marr pare përmbaruesi në projekte që janë rendësi për komunën? Sa i përket listës së projekteve, të projekti vendosja e ashensorit, po besoj që është fjala për ashensor në QKMF, mirëpo a është fjala për ashensor të ri apo renovim?

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Në faqen 3, të këtij materiali, e keni një strukturë të ndërtuar të këtij buxheti, që është një buxhet i mundshëm po jo një buxhet që do të plotësoj të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe institucioneve komunale. Droni është një pajisje që do të shërbej për monitorimin e punëve të kryetarit. Fondi i bashkëfinancimit do të shpenzohet vetëm për projektet kapitale për projektet që i kemi në bashkëfinancim me MAPL, Demos, Katar dhe donator tjerë. Sa i përket Arsimit për inflacion dhe shujta, ne jemi duke u ballafaquar me këtë problem të mësimdhënësve po shpresoj me përfundua deri në fund të këtij vite, na ka sjellë në vështirësi buxhetore, që janë në kërkesa të tyre që na qojnë nëpër gjykata, këto nuk janë ekzekutuar, dhe nuk ka pas fonde të

planifikuar, as të ministrisë së financave as të arsimit, dhe ju kanë lenë obligim komunave dhe ne duhet me i krye këto obligime, deshëm dhe nuk deshëm jemi tu i realizua.

**Drejtori i DBPZHR-së, Behxhet Maliqi;** Fjala përshëndetëse, qëllimi i çdo drejtori komunal duhet me kanë me rritë buxhetin, dikujt i pëlqen dikujt jo, po maksimalisht kemi me u mundua me menaxhua mirë, jemi të interesuar me bashfinancuar me donatorët kemi me bë maksimumin që 100% të këtyre mjeteve do të jenë në bashkëfinancim, qëllim ka me qenë së këto mjete me u rritë, qe ne konsiderojmë që janë mjete të vogla dhe nuk i mbulon nevojat e bujqve. Mendojmë së qëllimi që kemi ardhur këtu është realizua, këtu jemi me përmbush një program politik që ne e kemi zotua para qytetarëve, dhe kemi me vazhdua deri në fund të mandatit që këtë program politik me mbulua 100%.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:

**Besart Rrecaj-PDK:** Çështjen e ashensorit e harrove drejtor. Nuk është çështje dëshire këtu drejtor se ishallah kryhen deri në janar, po unë dhe ti e dimë shumë mirë së nuk kryhen deri në janar, puna e përmbaruesit ka me vazhdua edhe pas janarit, nëse nuk ka mundësi është diçka tjetër. Pa qenë jurist as ekonomist edhe hiq pa shkollë, ka qenë e turpshme prej tana qeverive që i ka nënshkrua kontratat kolektive edhe ja ka gjuajte pjesën financiare komunave, kjo është poshtërsi.

**Hysni Mehani-LVV:** Me Mentorin nuk merrna apologjia që ja bënë pushtetit është e gërditshme. E kam një pyetje për Besartën dhe drejtorin Hamit, u tha këtu që buxheti është rritë sipas kërkesave të drejtorëve, a keni bë ju dy kërkesa që me ju hiqë buxheti, p.sh. Besartës me ju dyfishua e ty drejtor Hamit me hiqë krejt, që me ja dhënë drejtorisë së bujqësisë, pra nëse bëhet sipas kërkesave a është krekës s'juaj që me tu zvogëluar buxheti? Edhe për çka po thotë Besarti nuk është e turpshme për gjitha qeveritë, e turpshme është për qatë qeveri që e ka marrë atë vendim, edhe ajo është qeveria e PDK-së. Edhe tutje kur jemi të kjo që po thotë Besarti të përgëzoj për një qëndrim parimor, po kjo dihet përse ndodhë, sepse përmbaruesi bënë marrëveshje me këta dy bosat edhe tani e qojnë komunën e dënojnë dhe në funde pjesën e përmbaruesit e ndajnë tani.

**Naser Bajraktari-IDEAL:** Drejtor të përgëzova që ke arrit me rritë buxhetin, po nuk po mundem metë kuptua ty a je drejtor i bujqësisë apo je drejtor i PDK-së, që bujqit me ditë ku me u drejtua. Sa i përket punës që e ke bë për këto tri vite duhet me pa një rezultat, ato mjete që i ke dhënë a i ke analizuar çka ka ec përpara në ato tri vite që i ke dhëna ato mjete, sa u ulë kostoja e prodhimit të atyre bujqve, ti je drejtor i bujqësisë dhe nuk duhet me bë diferencime, dhe unë di që ke bë diferencime po bujku është bujk, dhe duhet metë ardhur marrë.

**Afrim Kabashi-NSD:** Drejtor pyetja ke shume konkrete, se çka keni planifikuar në kategorinë e subvencioneve në shumën 360mijë€, ku ke pyetja me na tregua oreks politik, dhe kisha kërkuar me u përgjigj në mënyrë profesionale?

**Sala Jashari-PDK:** Fjala përshëndetëse, aktualisht shkolla Ahmet Delija nuk ka një infrastrukturë të përshtatshëm për aktivitetet sportive çka e kufizon mundësin e nxënësve për të marrë pjesë në sporte dhe aktivitete të tjera fizike, andaj kisha dashur me pas një sugjerim që të merret parasysh një ndërtim i një salle moderne sportive për këtë shkollë?

**Ali Lutfiu-PDK:** Fjala përshëndetëse, të pika 6, bashkëfinancimi, a hyn këtu edhe rregullimi-ndërtimi i QMF-së në lagjen tre, pasi që në këtë tabele nuk e pash që është cek?

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:

**Mentor Mehmeti-PDK:** Masi mu përmend emri, unë nuk ja maj zhagin askujt absolut, dhe nuk merrna me askënd, i kam idetë dhe konceptet e mija, unë nuk i shohë gabimet, unë i shohë të arriturat, opozita është me i pa gabimet, na kemi gabime plotë që po shohim, po tash X po na del 5.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj:

**Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu;** Ashensor është parapa në shtëpinë e pleqve. Kontratat kolektive është një problem në të gjitha komunat, deri në këtë vit as një komunë nuk ka pas në plani fikim paga shtesa mbi kufirin buxhetor, dhe po shpresoj që kanë me përfundua këtë vite këto obligime për kontrata kolektive. Bashkëfinancim janë ato kontrata që janë nënshkruar me ministrin dhe me donator të ndryshëm. Kemi një pjesë të obligimeve që është duke u zhvilluar procesi i tenderimit për QMF lagjja tre, dhe shpejt pritet me fillua.

**Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj;** Sa i përket kompleksit të U-së, ka qenë projekt i komunës shume shumë vite me parë, pastaj e ka marr ministria për financim, nuk e kanë vazhdua e kanë ndërpre komplet, na jemi ardhur në pushtet dhe U-ja ka pas me përfundua në fund të qershorit po u duftë me i bë disa renovime si me lye, i kemi lidhe disa kontrata, dhe se shpejti ka me u bë pranimi teknik, për objektin Ç-në i kemi disa diskutime me ministrin, nëse nuk dështojnë, për atë arsye e kemi nda një buxhete prej 100mij€, për me bë projektin. Parku antivandalizem, lojnat quhen kështu dhe nuk mundem me quajte ndryshe. Sa i përket subqendrave, subqendrat janë duke u zhvillua, i kemi pas disa pengesa si në Runik nga ministria, dhe është në procedurë, dhe këto tjerat janë duke vazhdua qysh i kemi plan programet dhe vitin e ardhshëm finalizohen komplet. Sa i përket ndriçimit publikë është një projekt në qytet dhe 52 fshatra që janë gjitha fshatrat dhe lagjet. Sa i përket kanalizimit në Qubrel janë kanë procedura pak me herët, është ndërpre një kontratë, tash është një kontratë që me finalizua këtë vite kanë mi rehatua një pjesë të madhe. Për pastrim të lumit jemi në dijeni, ministria i ka shpallur disa punime diku në Runik, Turiqec, dhe e ka përmend edhe lumin e Qubrelit, dhe nuk e dimë ku është, së nuk ka komunikim me neve, dhe ne nuk mundem me krye me këtë buxhet. Sa i përket lumit Klina, aty janë kanë do probleme me kanalizim gjatë vërshimeve, gjatë javës së ardhshme kanë me përfundua kanalizimi, dhe e pastrojmë edhe lumin aty ku ka mbet. Salla e sportit të shollës Ahmet Delija, u kanë procedurë në grandin e performances ka qenë një kontraktorë është ndërpre kontrata për shkak të disa telasheve, dhe gjatë javës së ardhshme zhvillohet procedura dhe lidhet kontrata për fushën e sportit.

**Drejtori i DBPZHR-së, Behzhet Maliqi;** Ne e kemi një marrëveshje me qytetaret që kemi me realizua një program të bujqësisë të cilin këna me realizua, a i pëlqen dikujt, a si pëlqen ajo është çështje tjetër. Problemi jonë është programi për bujqësi që kemi me realizua 100%, që jemi tu punua në ato objektiva, objektivi jonë është së mjetet monetare të destinuar për bujqësi janë maksimalisht në rritje qefte prej mjeteve të komunës qoftë prej donatorëve, jemi tu pritë marrëveshje të reja për vitet në vazhdim me donatoret.

**Kryesuesja; Fjalën ja kaloj;**

**Hysni Mehani-LVV;** Ky drejtori i urbanizmit se di a e kupton fjalën skuth, amo kur e kujtoj unë skuthin me del ky si profil, ky është qaq elokuent saqë ik ja len tjetrit nënshkrimet ne dorë dhe ja lenë veprat penale dhe kthehet apët që është një tip i jashtëzakonshëm skuth posesiv. Keni thënë së keni më bë UÇK-ën, justifikimet lej, tash arsyet gjej sa dushe e ke bë veç U-në edhe ato si ke bë, edhe prapë po bazohesh të qeveria, mirëpo ke thënë se ke bë edhe është e turpshme, për derisa janë tu vlu banesat tjera që kanë të bëjë për interesa private e personale. Të lojnat antivandalizem, the emrin e kanë kështu, po me ta pa dikush në buxhete është fyerje e logjikes, kish mundur me gjete ndonjë term tjetër së nuk është e hijshme, qysh po dinë me qenë skuth për çështjet tjera. Subqendrat the së vitin e ardhshëm përfundojnë, po në buxhet po thotë që shumica e subqendrave fillojnë ose vazhdojnë deri në vitin 2027, ti thua para 50 vetëve kryhen vitin e ardhshëm. Edhe subqendra e Runikut the së na ka pengua qeveria, ku qeveria t' ka mbështet, ti po thua na ka pengua, ti shtëpisë së kulturës ja ke shti bagerin se projekt i hajritë që u kanë tu u bë vallja e okarinës e ke ndërpre, dhe del këtu fol për interesa të qytetarëve edhe na lunë skuthin këtu, se



demek shi çka po thamë unë qysh po di me ja zi lojën këtu, po banu i sinqertë së nuk është hera e parë.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (19) vota për, (8) kundër dhe (0) abstënim miratohet Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit Komunal të Skenderajt për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026 dhe 2027.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshmet të personit fizik Naim Vojvoda, Nr.02-463/01-0042061/24, (Raporton);

**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** Fjala përshëndetëse, urime të gjithëve miratimi i buxhetit, para jush e keni propozim-vendimi Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Naim Vojvoda. Prona e paluajtshme në pronësi të Komunës së Skenderajt, me sipërfaqe prej 377m2, nga sipërfaqja e tërësishme prej 1897m2, kembehët me pronën e paluajtshme në pronësi të Naim Vojvoda, me sipërfaqe prej 377m2, Zona Kadastrale Skenderaj, evidentuar me certifikatë të pronësisë, sipërfaqet janë vërtetuar sipas verifikimeve nga gjeodetët profesional të ZKK-së. Ky inicim për këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme të personit juridik të lartcekur me iniciativë të komunës behët pas marrjes së pronës private të personit fizik në bazë të dokumenteve të planifikimit hapësinor për arritjen e qëllimit të interesit publikë, me rastin e realizimit të projektit të ndërtimit dhe zgjerimit të rrugëve në qytet me kubëza betoni.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Hysni Mehani-LVV:** Për besë jam mundua me kuptua këtë, po pa sqarim shtesë të detajuar që do duhet me ardhur në kuvend përmes projektorit është shtirë me kuptua së çka ka ndodhur në këtë proces. Në parim nuk e votoj sepse jam i bindur pa naje interes personal të këtyre zyrtarëve komunal nuk ja benë këmbimin e pronës askujt. Pra mundet mem ik naje detaj që a po vjen kërkesa prej palës s'po shkon kërkesa prej institucioni, dhe ju kisha lutë që kur kemi këmbime tjera me pas projektor që me u jap detaje me shume, sepse unë jam i bindur që shumica e asamblistëve kanë me votua e nuk e dinë sak cila pronë po ndërrohet.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kaloj;

**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** E keni bazën ligjore në propozim së qysh ka shkua procedura dhe i keni gjitha dokumentet e bashkangjitur, këmbimi i pronës çdo herë kur behët ruhet interesi publik, dhe këmbimi behët në sipërfaqe dhe zonët të njëjtë duke e respektuar Hartën zonale.

**Kryesuesja:** Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (3) kundër dhe (1) abstënim miratohet Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshmet të personit fizik Naim Vojvoda.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshmet të personave fizik Faik Vojvoda dhe Sadete Vojvoda, (bashkëpronësi), me Nr.02-463/01-0042070/24, të datës 27.08.2024, (Raporton);

**Kryetari i Komunës Fadil Nura;** Pak a shumë është propozim i njëjte me persona të ndryshëm në vendin e njëjta, materialin e keni pas me kohe, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

**Kryesuesja:** E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (0) kundër dhe (0) abstënim miratohet Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshmet të personave fizik Faik Vojvoda dhe Sadete Vojvoda, (bashkëpronësi).

Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për miratimin e përfundimtar të ofertës nga Shprehja e Interesit, për marrjen në shfrytëzim afatgjatë (99), pronën e paluajtshme të Komunës me sipërfaqe prej 3000m2,



ofertuesit personit juridik “Ismet Commerce” NTSH, me Nr.01-463/01-003936/24, të datës 14.08.2024, (Raporton anëtarit i komisionit);

**Anëtarja-kryesuesja e komisionit Blerta Dobra Geci:** Fjala përshëndetëse, këtu po ulëm në cilësinë e anëtares së komisionit, gjegjësisht kryesueses së komisionit, për të prezantuar një procedurë që e kemi realizuar ai trup nga kuvendit komunal në lidhje me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale deri 99 vite personit juridik Ismet Comerci, sipas Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshëm të Komunës, dhe Rregullores (QRK) Nr.09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, duke vepruar sipas Shprehjes së Interesit me Nr.01-463/02-0033949/24, i datës 18.07.2024, dhe Njoftimit publik për shpalljen e ofertës fituese nga shprehja të interesit me Nr.01-463/01-0037144/24, të datës 05.08.2024, duke u bazuar në Plani Zhvillimor Komunal 2017-2025, si dhe Hartën Zonale të Komunës së Skenderaj 2020-2028, Oferta me Nr.05-463/01-0036497/24, të datës 01.08.2024, personit juridik “Ismeti Commerc” NTSH, me pronar Ismet Mustafa B.I. nga Klina e Poshtme, është përfitues i Shprehjes së interesit publik, sipas njoftimit publik të komisionit vlerësues, me Nr.01-463/01-0037144/24 të datës 05.08.2024, në kohëzgjatje deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, për pronën e paluajtshme në pronësi të komunës së Skenderajt, si ofertë e vetme aplikuese, ipet në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme e komunës deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, me sipërfaqe prej 3000m<sup>2</sup>, të ndarë nga sipërfaqja e përgjithshme 11232m<sup>2</sup>, nga ngastra 699-2 Zona katastrale Skenderaj. Qëllimi i dhënies së pronës është për ndërtimin e objekteve me destinim afarizëm-banimit, sipas kriterëve ndërtuese të përcaktuara nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit. Ofertuesi Personi juridik, "Ismet Commerce" NTSH, me ofertën me nr. 05-463/01-0036497/24, si ofertë e vetme aplikuese dhe mjaftë e favorshme për Komunën e Skenderajt që përmban: verën investive në shume prej 2,700.000.0 euro (dy milion e shtatëqind mijë euro) (bashkangjitur shkresa), punësimin e 168 punëtoreve (bashkangjitur shkresa me listën e punëtoreve pjesëmarrës që do të jene në realizimin e kësaj veprimtarie), interesin/përfitimin ekonomik financiar të Komunës ofrimin e 21% të sipërfaqes së tërësishme të ndërtimit të shndërruara në mjete financiare të cilat do të llogariten nga komisioni Komunal i DUS-së conform rregullores Komunale në fugi, rritjen e vlerës së Pronës nga një prone e pa ndërtuar në një prone me ndërtim, gjelbërim dhe Park, Dëshminë e pagesës si depozitë në vlerë prej 50,000.00€, në xhironlogarinë e komunës.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Hysni Mehani-LVV:** E ftoj drejtoreshën që tash paska dhënë dorëheqje se e paska krye punën perse u bë drejtoresh. Pse po e jepni pronën që e ka vlerën 1 milion euro për 500 mijë euro?

Ju vetë e keni pranë që vlera e asaj prone është 1 milion euro. Pse po e jepni për 500 mijë?

Dëgjimi i Videos:

Siç e dëgjuat drejtoreshën në seancën kur është iniciuar dhënia e kësaj prone keni thanë që minimumi do të jenë 30 punëtorë tek pjesa e afarizmit që duhet t'i paraqesë ofertuesi. Keni thanë që komuna do të përfitojë 1 milion euro sepse është një pjesë kogja e madhe e sipërfaqes që po jepet në shfrytëzim. Keni thanë që do të ketë transparencë. Ku janë 30 punëtorët që ofertuesi do duhej t'i paraqiste në ofertë? A i lexuat ndokund? Ku janë 1 milion eurot që do duhej t'i përfitonte komuna? A e din dikush prej juva asamblistëve të PDK-së si do duket ky objekt, sa banesa e sa lokale? Prej asaj që keni thanë ju, e njëjtë ka mbetur veç madhësia e pronës që po gllabëroni.

Në parim, në si Lëvizje, jemi kundër dhënies së pronës komunale për banesa. Ligji nuk e lejon! Por ju meqë po e jepni, pse bile nuk po e jepni me çmimin real të tregut? 1 milion është vlera e pronës, 1 milion le t'i përfitojë komuna, jo 500 mijë euro! Sepse 500 mijë tjera na e dimë që

përfundojnë në xhepat tuaj, ose përkthehen në m<sup>2</sup> po për juve. Na e kemi pa që z. Nura njëkohësisht teksa me njërin vëlla këmbën pronën komunale, prej tjetrit vëlla blen "Pent House". Kush po pritni me ju besu juve, që ju po ja falni një investitori 500 mijë euro!? Shumë më e ndershme do të ishte me na tregu qysh i keni nda ato 500 mijë? Ka sa m<sup>2</sup> i keni marrë? Sepse krejt e dimë që "Ismet Comerci" është veç punë kryerës në këtë objekt. 500 mijë euro fitim për fillim e disa miliona euro fitim nga shitja e lokaleve e banesave që do të ndërtohen në pronën komunale. Kështu i rritet vlera pronës komunale a? Komisioni që e ka dhanë këtë pronë e ka vendin në burg. Dhe është në detyrën e policisë dhe prokurorisë t'i dërgojë anëtarët e këtij komisioni atje ku e kanë vendin burg. Dhe, shih ti çfarë thotë komisioni: Komisioni thotë që për me e marrë një pronë që vlen 1 milion euro për 500 mijë euro, pra 50% ma lirë, paska qenë i interesuar veç një ndërtues! A ka dikush në këtë sallë e nga ata që na dëgjojnë që beson këtë maskaradë? Komisioni thotë: po citoj, "Ofertuesi sipas ofertës Komunes së Skenderajt për marrjen në shfrytëzim të pronës i ofron 21% të sipërfaqes së ndërtimit të objektit banesor P+7, nga sipërfaqja totale e ndërtimit, sipas ofertës nga kjo veprimtari ofron punësimin e 168 punëtorëve, Komisioni ka mashtruar sepse investuesi nuk i ka plotësuar kriteret sipas ligjeve: Ofertuesi nuk e plotëson kriterin e dytë, kriteri i cili kërkon "Numrin e të punësuarve nga investimi". Bazuar në rregulloren 09-2020. A e dini sa është numri i të punësuarve nga investimi? Zero.. Zero. 168 punëtorët e përmendur si të punësuar nga investimi, janë punëtorët e krahut që do ta ndërtojnë objektin. Të punësuar të përkohshëm e sporadik. Disa punëtorë të armaturës e disa muratorë, që kur të ndërtohet objekti do të kërkojnë punë gjetkë, derisa milionerët aksionarë do të fillojnë të inkasojnë milionat. Prej kurshit o shkollovana, punëtorët që e ndërtojnë objektin quhen të punësuar nga investimi? Kjo i bjen si me thanë po investoj në ndërtimin e një fabrike. E të punësuarit e fabrikës do të jenë vetëm ata që e ndërtojnë. Dhe mandej fabrika shuhet.

Unë çuditëm qysh Ismet Aliu ka mujt me ba këtë gjë, sepse për kryesuesen e komisionit po e dina që ka konflikt interesi, është tu dashtë me ja jap pronën vjehrrit.

Unë e di që kjo është brenda logjikës suaj që keni qeverisur që 25 vjet. Janë ndërtu shkolla që kurrë nxënës në të nuk ka hy, qëllimi ka qenë veç me marr tenderin. Ndërkohë që ne si qytet vuajmë për çerdhe. Janë dhanë shtalla që tash kanë mbetur ngrehina, derisa fermerët e vërtetë i mbajnë kafshët në shtalla të mbuluara me llastikë. Vetë si kuvend kemi nda mjete për t'ju dalë në ndihmë fermerëve që mbajnë kafshët me llastik, derisa me dhjetëra shtalla janë bosh.

Janë dhënë grande me pemë që kurrë kush frutë prej tyre nuk ka hangër. Ama bollni bre mo. Bollni. Se kjo logjik duhet me marr fund. Nuk po merrem me aspektin procedural në këtë seancë, sepse për atë do t'iu drejtohem organeve kompetente. Plus që koha e limituar prej 5 minutave ma pamundëson më i shpërfaqë të gjitha dallaveret e këtij propozim-vendimi. Por unë e di, që kujtdo që i ka mbetur një troh krenari në shpirt, nuk e voton këtë propozim që shton miliona tek milionerët, ndërsa tkurrë edhe më pronën komunale në mungesë të së cilës dy çerdhet që kanë filluar të ndërtohen në oborre të shkollave sepse nuk kishte prona tjera. Ndërsa tash paska prona për t'iu dhënë milionerëve. Unë këtu ju kisha lutë kush do që e ka pak krenari që mos me votua këtë propozim vendim sepse është një prej akteve me të turpshme që kemi me mbajt mend si asamblist.

**Naser Bajraktari-IDEAL:** Ne baze te propozim vendimit për dhënien ne shfrytëzim afatgjate për 99 vite te pronës se paluajtshme komunale, për ofertuesin e vetëm Ismet Comerc NTSH. Duke ditur rendësin dhe vlerën e pronës se paluajtshme komunale, është për te ardhur keq, sa letë ipet prona komunale pa vlerësim te drejt dhe real te kësaj prone. Ku dihet se vlera pronave ne qytet ka vlera marramendës te vlerësimit sipas tregut ne komune e Skenderaj, ndërsa komisioni i përberë prej 5 anëtareve ka bere vlerësim e ofertës se vetme te ofertuesit Ismet Comerc i cili ne këmbim te kësaj prone ka ofertuar qe vlera e investimit te jete mbi 2,7 milion, ndërsa 21% përfitimti i komunës

për 99 vite. Në baze të llogaritjes së përqindjes prej 21% sipas ofertës së Ismet Comerci komuna do të përfitoj një shumë simbolike mujore prej 400€ në muaj, që i bije për 99 vite të këtë përfitim 500 mijë euro. Duke u bazuar në vlerën që ka kjo prone në treg, komuna po humb mbi 20% të vlerës së reale të tregut. Kriter për dhënien e pronës së paluajtshme për do ofertues të mundshëm, përfitimi i komunës është dashtë të caktohet jo më pak se 40% për interesat sepse prona ku është në zëmër të Skenderajt dhe pronat tjera që shkojnë mbi 30% dhe ju e keni marr me 21 % vetë të shtinë me dyshua së këtu ka manipulime sepse për një 400€ qera në muaj që i bien një auto larje me 20m<sup>2</sup> ato pare i kish përfitua për këto vite.

**Anëtarja-kryesuesja e komisionit Blerta Dobra Geci:** Po ju elaborojë pak këtë çështje, vlerën as së ka caktua 500 mijë€ investitori d.m.th. 21% as unë si kryesuese e komisionit po as ju këtu, vlerën ka me llogarit komisioni komunal pas ndërtimit të kompleksit afarist banesor të objektit siç është caktuar në ofertë atëherë do të bëhet përlllogaritja e 21% sipas rregullores komunale të vitit 2017 që e përcakton m<sup>2</sup>, së çfarë çmimi ka kjo varet prej komisionit nuk mundem me ditë tash, po për afërsisht qysh e kemi përlllogarit do të afrohet 1 milion€, siç kanë qenë edhe rastet e mëparshme. E këto hipoteza prej 500 mijë€ i keni llogarit ju me mendjen e juaj pa u bazua në rregullore, vlera investive do të jetë 2,700,000.00€, do të punësohen 168 persona gjatë investimit, që ofertuesi e ka paraqit si provë, dhe investimi do të përcillet nga zyrtaret komunal që do të caktohen në kontratë pas nënshkrimit nga ana e kryetarit. Tjetra, kush ka përfitua këtu, a vjehri jem a kush për këtë do të jepesh përgjegjësi po të thamë këtu publikisht, së mjaftë kemi dëgjuar këtu tu akuzua e tu bë shpifje po me mua do të kesh pak f 'shtirë po ta them publikisht së ke me dhënë përgjegjësi për këto shpifje dhe këtë deklarata që i the pak me herët, do të përballësh me organet e drejtësisë, se pa fakt, pa bazë del e flet kësi gjana turpshme për ty, e aq me pak për një njeri që ka dhënë aq shumë për Drenicën e për Kosovën në përgjithësi. E unë japi përgjegjësi për ato fjalë që i qite në incizim së vlera do të jetë afër 1 milion €, e di sigurt së e kam pa rregulloren dhe çmimin e vlerës së tregut, do të jepesh përgjegjësi së ke fol mjaft këto vite me ke akuzua sa kam qenë drejtoresh dhe nuk ke mundur më gjete sene në procedura sa një germe. E njëjta vlen edhe për zotriun që e caktoj vlerën 500 mijë€, nuk do të jetë ajo shumë, po është komisionin që do ta llogarit, kur do të përfundoj objekti do të llogaritet 21%. Na nuk jemi në procedura të tenderimit as të ankandit publik me caktua vlerën fillestare, kjo është shprehje e interesit aq sa ka shpreh ofertuesi me protokoll dhe me zarf të mbyllur ka ardhur në zyre të ne. Kam ardhur këtu si anëtare e komisionit e kam ndje të nevojshme me i shpjegua disa detaje e jo për përfundimin e punëve të mija Hysni Mehani, siç e the, po për gjitha këto ke me dhënë përgjegjësi dhe do të ngriti padi personalisht kundër teje dhe shihmi në gjykatë.

**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Fjala përshëndetëse, nuk desha me marr fjalën po mu përmend pent hausi dhe e ndjeva si obligim me ju përgjigj anëtarit të asamblesë. Krejt procedura e dhënies në shfrytëzim është me bazë ligjore dhe është gjithçka në rregull, po përfaqësuesi i Dejana Mihali me ardh këtu me na shitë pallavra është e pa nevojshme, është mirë kur të kontestosh diçka me fakte me kontestua, thotë ligji nuk e lejon, cili ligj cili nen, nuk është hera e parë që po japim prona në shfrytëzime dhe ky objekt ku të ndërtohet do të nënshtrahet tatimit në pronë që do të ketë të hyra çdo vite të përhershme që është interes direkt i komunës, referonju ligjit pak, Unë i kam thënë të gjithëve me mirësjellje të plotë që të keni kujdes mos apostrofoni çështjet familjare private sepse nuk kemi nevojë. Dhe ti që ma përmende pent hausin e ke qua në prokurori në anti korrupsion dhe ke marr përgjigje çka po lidhesh prej meje ti, çka po donë, se s'po ki ma material.

**Kryesuesja; Fjalën ja kaloj:**

**Anëtarja-kryesuesja e komisionit Blerta Dobra Geci:** Ismet Comerci nuk është investitor, po do të jetë pronar i pronës publike që ka kaluar në procedurë të dhënies në shfrytëzim për 99 vite.

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj:

**Hysni Mehani-LVV:** Unë për pasoja juridike dhe fizike e me kësi kërcënimesh e kam kaluar këtë fazë nuk me bëjnë përshtypje, pra mua me kanë thënë me shkua plumbi ku është vendi, unë e di këtë punë, amo 5 pare si dha. Edhe pak e pa sigurt kryesues në mënyrë të vazhdueshme bere gjuhe fyese, denigruese, plus me tone kërcënuese, unë marr përgjegjësi penale për krejt ato çka e thamë, edhe thuhet fjala një herë, nëse ja nisi me bërtit nuk ndreqi kurgjo, edhe nuk mundesh ti mu mem qitë prej takti nuk bie në atë nivel kurrë. z. Nura e ke ble pent hausin prej vëllait të pronarit qe e ke ndërrua token kjo është e vërtetë, asgjë nuk po thamë unë shpifje, tjetra po thua me ju referua ligjit, të rregullorja neni 1.1.2 thotë; numri i të punësuarve nga investimi, unë konsideroj që numri i të punësuarve nga investimi nuk janë punëtor që ndërtojnë investimin sepse kjo nuk ka logjik, rrjedhimisht kjo do duhej me ra si kriter, se nuk e ka prua as një punëtor që e punëson nga investimi, a pe kupton z. Nura, a po pajtohesh, a mundesh me thanë që nuk është kështu. Tjetra komisioni kur e ka hap ofertën ka bë shkëlje, sepse kur e ka hap ofertën nuk i ka pas krejt dokumentacionin është dashur me marr pauzë e me dal me marr garancinë prej 50 mijë€. Mos të flasim për rritjen e vlerës, jemi tu fol për rritjen e vlerës në dimension të interesit publik, me tatim në pronë nuk e thotë këtu, prona jepet për zhvillim ekonomik jo për tatim në pronë si kriter. Të vjehri juaj, unë kam konsideratë për këdo që ka kontribuu në luftë, edhe për besë kur kemi kontribuar ne në luftë si familje do tjerë na kanë thënë mos na bini ksajde së po javë shohim sherrin. Po masë lufte kerkuj si kemi borq asgjë, edhe jemi të gjithë të barabartë. Sa i përket padive që ku janë organet vazhdo tutje, së krejt këta çka janë në sallë e dinë që kjo çka po e them është e vërtetë, e kjo punë ka rendësi, s'ka rendësi çka thua ti.

**Kryesuesja:** Me kaq mbyllet debati, konstatojmë me (17) vota për, (7) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Propozim-vendim për miratimin e përfundimtar të ofertës nga Shprehja e Interesit, për marrjen në shfrytëzim afatgjatë (99), pronën e paluajtshme të Komunës me sipërfaqe prej 3000m<sup>2</sup>, ofertuesit personit juridik "Ismet Commerce" NTSH,

Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës,

-Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar me Nr.09-400/01-0043919, të datës 06.09.2024, i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Janar-Qershor 2024, me Nr.02-400/01-0043973/24, i datës 09.09.2024, (Raporton);

**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni, propozim-vendimi Për miratimin e raportit përfundimtar, i hartuar nga komisioni komunal i caktuar nga kryetari i komunës me vendimin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara kryesisht nga era dhe breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Janar-Qershor 2024. Dëme janë shkaktuar në bujqësi gjithsej 58 raste, në ekonomi familjare 2 raste, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej 86,373.16€. Raporti përfundimtar i dëmeve, i shqyrtuar nga kryetari i komunës, përmban një vlerësim profesional nga të dhënat e evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim të komisionit paraprak të emëruar nga kryetari i komunës dhe kërkesave për kompensim të dëmeve nga qytetarët (familjet) e dëmtuara nga erërat, breshëri dhe fatkeqësitë e tjera të cekura në nenin një, dhe i njëjti raport me miratimin në kuvendin komunal në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit i dorëzohet Agjencisë së menaxhimit emergjent, dhe një kopje të njëjtësuar Komisionit Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

**Kryesuesja;** E hap debatin, fjalën ja kaloj:

**Besart Rrecaj-PDK:** Drejtor nëse nuk jam gabim, sipas informatave, prej këtyre dëmeve që janë bë janë kompensua shtëpi, toka bujqësore, mirëpo nuk janë kompensua bizneset, tash kur shkon ky raport a pritet me u kompensua edhe bizneset apo sa për me u miratua e me qua dorën kështu?

**Hysni Mehani-LVV:** Drejtor ne kemi votua edhe herëve tjera këso raste, a ka ndonjë rast që kanë marr përgjigje pozitive, a veç je tu e bë një farë fajësimi para fermerëve, se çka po bëjmë? Dhe imagjino çka po thotë kryesuesja votoni një material që është pak i pa lexuar, e këta material me ja dërgua nivelit qendror e po pritni me javë marr parasysh ah, ma se këto i bëjnë dem kom unës, dhe ju kisha lut me kanë me të kujdesshme.

**Afrim Kabashi-NSD:** Drejtor këna votua dhe jemi me votua kësi raste, po a keni ndonjë rast që është kthye përgjigja prej nivelit qendror, dhe materiali të unë është i lexuar.

**Naser Baraktari-IDEAL:** Drejtor, a e ki ndonjë rast që nuk është dashur me përfitua e ka përfitua, në këtë raport, së ata që nuk është dashur me përfitua e kanë përfitua e di. Po a keni këtu ata që është dashur me përfitua e s'kanë përfitua, nëse ki asi e votoj, nëse ski nuk e votoj.

**Mentor Mehmeti-PDK:** Hysni me rendësi e ki, së materiali nuk është i lexuar, po unë e kam një shqetësim, së ky raporte është për këtë vite, e nuk janë dëme për vitet paraprake, e nuk e pash në këtë raport që ka dëme nga djegiet e hamullorëve, se e di që ka pas dëme nga këto djegie.

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj;

**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Besart ekziston ligji për fatkeqësitë natyrore dhe rregullorja për metodologjinë pre vlerësimin e dëmeve, dhe në këto bazohet bazohem komisioni për vlerësimin e dëmeve pa marr parasysh ku janë ato dëme nuk e specifikon. Detyra jonë është për çdo kërkesë që vjen për kompensim të dëmeve, komisioni është i detyruar me dal në vendin e ngjarjes me bë raportin me bë vlerësimin dhe me sjellë në kuvend për votim, dhe pas votimit me ja dërgua qeveris, kështu e thotë ligji. Dhe në qoftë së keni dyshime për X lenden mundeni me bë kërkesë për qasje në dokumente, me ardh me shikua, po ashtu i keni organet drejtoju bane kallëzime.

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj;

**Hysni Mehani-LVV:** Drejtor sëmundjet a hinë të fatkeqësitë natyrore?

**Naser Bajraktari-IDEAL:** Drejtor a ke mundur me qenë i saktë a ka fry era krejt komunën e Skenderajt apo vetëm disa fshatra?

**Kryesuesja;** Fjalën ja kaloj;

**Drejtori i DSHP-së, Alban Shala;** Komisioni shkon në vendin e ngjarjes edhe e shikon demin e benë raportin dhe e vlerëson demin dhe e sjell në kuvend dhe pas miratimit e dërgon ne qeveri për kompensim.

**Kryesuesja:** Me kaq mbyllet debati, konstatojmë me (21) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim, miratohet Propozim-vendim për miratimin e Raportit përfundimtar me Nr.09-400/01-0043919, të datës 06.09.2024, i hartuar nga komisioni komunal, për demet të shkaktuar nga era, breshëri dhe fatkeqësitë tjera për muajin Janar-Qershor 2024.

Vazhdojmë me piken 9 të rendit të ditës:

-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, fjalën ja kaloj;

**Afrim Kabashi-NSD:** Për pyetjen e parë kam marr përgjigje, Për Drejtorin e Urbanizmit Driton Mula; Drejtor a mund te na njoftoni konkretisht a keni ndonjë afat të caktuar në zgjidhjen e çështjes së kanalizimit në disa lagje të fshatit Polac e konkretisht pjesën e lagjes të xhamisë?

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Drejtori i DUMA-së, Driton Mula;** Afrim janë tu punua në Polac për kanalizim nuk mundem me dhanë datë kur kryhet së krejt po varet prej buxheti.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Ali Lutfiu-PDK:** Kërkesë, Drejtorisë së arsimit. I nderuar drejtor z. Kastriot Duraku. Ne ketë vit shkollor ne si prindër kemi pas shumë telashe rreth përzgjedhjes së shtëpive botuese, një numër te librave qe i kemi ble njëherë është dashur ti kthejmë e ti e ti marrim te një shtëpie botuese tjetër.

A ka mundësi që ju si drejtori të dilni me një vendim që librat që i marrim të ceket të cilës shtëpi botuese duhet të jenë në mënyrë që të kemi të qartë në si prindër se cilat libra duhet të kërkojmë. Në këtë mënyrë po ju ipet hapësirë secilit mësimdhënës që të caktoj vet shtëpinë botuese e që pasojat po i bart nxënësi dhe prindi. Ju lus të merreni seriozisht me këtë kërkesë. Shpresoj që vitin tjetër të mos përsëritet ky problem.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Drejtorit DKA-së, Kastriot Duraku:** Fjala përshëndetëse, përzgjedhjen e librave e bëjnë mësimdhënësit dhe si drejtori nuk kemi drejt të marr vendim se cilat tekste të shtëpive botuese me i përzgjedh mësimdhënësi, po kjo i takon mësimdhënësit, dhe është e vërtetë çka po thua ti së shume shkolla po punojnë me shtëpi botuese të ndryshme, po kjo po ndodh në të gjithë territorin e Kosovës.

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Hysni Mehani-LVV:** Drejtorisë së Shëndetësisë: Në këtë konkurs, siç edhe mund ta shihni, kandidatja që ka më së shumti pikë në test me shkrim nuk pranohet në punë, ndërsa kandidatja që ka më së paku pikë në test me shkrim, pranohet. E gjitha kjo, pasi që kandidatja me më së paku pikë është anëtare e PDK-së dhe këtë hile në përzgjedhje e kishin mundësuar dy këshilltarët komunalë nga radhët e PDK-së të cilët ishin anëtarë të komisionit përzgjedhës, e të cilët gjatë intervistës e kishin vlerësuar me pikë minimale kandidaten që kishte pasur më së shumti pikë në test me shkrim, ndërsa me pikët maksimale anëtares e PDK-së që kishte më së paku pikë në test me shkrim. Ligji për zyrtarët publik i referoheni shkarazi, për të mundësuar shkeljen e ligjit dhe mundësuar punësime partiake. Drejtoreshë, si ndiheni kur bëni diskriminime në baza partiake në mënyrë kaq të ulët dhe kush ka qenë personi që u ka kërkuar të punësoni këtë militante dhe dy binjakët e partisë, Fadili apo Samiu? Në material e ka prezantua me tabelë.

-Drejtorisë së Urbanizmit: Cilët janë zyrtarët komunalë që Prokuroria ka ngritur rast kundër tyre për rastin "Andrra Residence"?

-Drejtorisë së Arsimit: Mësimdhënësve iu ishte kërkuar që të caktojnë se me cilin libër të shtëpisë botuese përkatëse duan të punojnë. Por, kur ka filluar viti shkollor një numër i konsiderueshëm i këtyre përzgjedhjeve që kishin bërë mësimdhënësit ishte ndërruar dhe ishte pikërisht DKA ajo që kishte ndërhyrë në përzgjedhjet e mësimdhënësve. Sa kanë përfituar zyrtarët e DKA-së nga favorizimi që ia kanë bërë një shtëpie botuese?

**Kryesuesja:** Fjalën ja kalojë:

**Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi:** Fjala përshëndetëse, edhe pse kandidatja në fjalë, ka dal me e suksesshme në test me shkrim, kanë qenë edhe dy faza tjera të vlerësimit, ajo e intervistës edhe e CV, ku sipas komisionit kandidatja tjetër ka marr pikë maksimale edhe u pranua si infermiere.

**Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj:** Unë jam drejtor i urbanizmit e kam punë primare, i kam edhe 3-4 punë sekondare, nuk jam tu punua as në gjykatë as në polici, unë nuk i di.

**Drejtorit DKA-së, Kastriot Duraku:** Mësimdhënësit i zgjedhin librat vetë, as drejtori sa ministria as inspektorati nuk kanë ndikua të mësimdhënësit që cilat libra me i zgjedh apo marrëveshje qysh po pretendon.

**Kryesuesja:** Me kaq mbyllet ky takimi, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENI ADMINISTRATIV/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/OPŠTINA INŠTITUCIJA  
SKENDERAJ



Nr.  
04 052/09-0048205/24  
DATA  
10-10-2024  
E  
C



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna Skenderaj**  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

**Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor**

**RAPORTI FINANCIAR**  
**i realizimit të buxhetit Komunal**  
**Janar – Shtator 2024**

Tetor 2024



## Permbajtja:

Raporti Përfundimtar Financiar Janar-Shtator 2024.....	3
1. Kërkesat për raportim .....	3
2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE .....	3
3. Raporti i Ekzekutimit te Buxhetit 2024 TABELA Nr 1 .....	
4. TË HYRAT VETANAKE JANAR-SHTATOR 2024.....	5
Te hyrat Vetanake komunale - Janar-shtator 2024.....	5
5. SHPENZIMET BUXHETORE .....	7
Tabela nr. 4 Projektet kapitale të realizuara Janar-Shtator 2024 .....	9

# Raporti Përfundimtar Financiar Janar-Shtator 2024

## 1. Kërkesat për raportim

Raporti Financiar Komunal për periudhën Janar – Shtator 2024, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të “Ligjit Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe Statutit Komunal.

Raporti Financiar Komunal ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Periudha e raportimit karakterizohet me faktin se:

- të hyrat komunale të realizuara deri në shtator 2024 janë alokuar sipas planit buxhetor 2024 ,
- të gjitha mjetet e pa shpenzuara nga tremujoret paraprak përmes procedurave të bartjes sipas rregullores financiare janë bartë në tremujorin në vijim për të gjitha kategoritë përjashtuar atë të pagave dhe
- me vendime gjyqësore/përmbartimore në emër shtesave (shujtat, licencimi, inflacioni etj.) bazuar në kontratën kolektive për mësimdhënës të arsimit parauniversitar janë pagua përmes Thesarit 2,208,473.72 € shumë e paguar nga kategoritë e ndryshme, nga sa janë paguar nga kategoritë janë të detajuar neper tabelat sipas analitikes .

## 2. TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”.

Buxheti i aprovuar për vitin 2024 ishte 18,582,310.00 € por me dhe ndryshimet pozitive gjatë vitit si: bartja e të hyrave komunale të pa shpenzuara nga viti paraprak dhe granti i performancës (DEMOS-i) i shpërndarë në pesë kategori ekonomike është 19,529,778.83 € :

Kategoritë ekonomike	B. fillestar	B. aktual
Pagat dhe Shtesat	10,529,849.00	10,529,849.00
Mallrat dhe Shërbimet	2,386,428.18	2,388,253.96
Shërbimet Komunale	289,322.82	309,126.71
Subvencionet dhe transferet	1,002,000.00	1,026,952.97
Investimet Kapitale	4,374,710.00	5,275,596.19
<b>Gjithsej</b>	<b>18,582,310.00</b>	<b>19,529,778.83</b>

TABELA NR 1 RAPORTI I BUXHETIT DHE EKZEKUTIMIT TË TIJ : JANAR- SHTATOR 2024


FONDET BURIMORE	Buxheti fillestar	Buxheti Aktual	Shpenzimet (pagesat) 2024	Shpenzimet (pagesat) 2023	% e realizimit
					3/2
0	1	2	3	4	5
<b>GRANTI I PERGJITHSHËM</b>	<b>17,283,039.00</b>	<b>17,283,039.00</b>	<b>14,588,332.31</b>	<b>11,319,472.34</b>	<b>84.41</b>
Pagat dhe Shtesat	10,529,849.00	10,529,849.00	9,154,515.05	7,195,632.03	86.94
Mallrat dhe Shërbimet	2,329,428.18	2,329,428.18	1,804,462.65	1,495,117.01	77.46
Shërbimet Komunale	289,322.82	289,322.82	209,144.31	193,754.17	72.29
Subvencionet	932,000.00	932,000.00	825,230.60	692,066.80	88.54
Investimet Kapitale	3,202,439.00	3,202,439.00	2,594,979.70	1,742,902.33	81.03
Rezerva					
<b>TË HYRAT VETANAKE Aktuale</b>	<b>1,299,271.00</b>	<b>1,299,271.00</b>	<b>1,087,474.76</b>	<b>740,984.03</b>	<b>83.70</b>
Pagat dhe Shtesat				33,999.99	
Mallrat dhe Shërbimet	57,000.00	57,000.00	33,283.18	4,608.73	58.39
Shërbimet Komunale					-
Subvencionet	70,000.00	70,000.00	64,935.15	15,382.00	-
Investimet Kapitale	1,172,271.00	1,172,271.00	989,256.43	686,993.31	84.39
Rezerva					-
<b>TË HYRAT E BARTURA</b>	<b>-</b>	<b>344,349.32</b>	<b>197,772.75</b>	<b>308,017.45</b>	<b>-</b>
Pagat dhe Shtesat					-
Mallrat dhe Shërbimet		1,825.78	1,158.00		-
Shërbimet Komunale		19,803.89	14,324.31	21,454.80	-
Subvencionet		24,952.97	21,476.80	14,180.00	-
Investimet Kapitale		297,766.68	160,813.64	272,382.65	-
<b>DONACIONET</b>	<b>-</b>	<b>603,119.51</b>	<b>435,155.27</b>	<b>416,593.39</b>	<b>-</b>
Pagat dhe Shtesat				4,130.43	-
Mallrat dhe Shërbimet			-	-	-
Shërbimet Komunale				-	-
Subvencionet				412,462.96	
Investimet Kapitale		603,119.51	435,155.27		
<b>HUAMARRJA E JASHTME</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Pagat dhe Mëditjet					
Mallrat dhe Shërbimet					
Shërbimet Komunale					
Subvencionet					
Investimet Kapitale					
<b>GJITHSEJ K.EKONOMIKE</b>	<b>18,582,310.00</b>	<b>19,529,778.83</b>	<b>16,308,735.09</b>	<b>12,785,067.21</b>	<b>83.51</b>
Pagat dhe Shtesat	10,529,849.00	10,529,849.00	9,154,515.05	7,233,762.45	86.94
Mallrat dhe Shërbimet	2,386,428.18	2,388,253.96	1,838,903.83	1,499,725.74	77.00
Shërbimet Komunale	289,322.82	309,126.71	223,468.62	215,208.97	72.29
Subvencionet	1,002,000.00	1,026,952.97	911,642.55	1,134,091.76	88.77
Investimet Kapitale	4,374,710.00	5,275,596.19	4,180,205.04	2,702,278.29	79.24
Rezerva	-		-	-	

**- Përqindja e kategorive ekonomike në pjesëmarrjen e buxhetit aktual Komunal :**

Nga të dhënat e buxhetit aktual të planifikuar del se kategoria Paga dhe Shtesa merr pjesë me 53.92 % të buxhetit të përgjithshëm , mallrat dhe shërbimet 12.23 %, komunalit 1.58 %, subvencionet dhe transferet 5.26 % dhe kategoria e projekteve kapitale merr pjesë me 27.01 %

Sipas tabelës mund të shihet se shpenzimet e përgjithshme për periudhën janar-shtator 2024 janë 16,308,735.09 ose 83.51 % të buxhetit aktual.

Grafikisht:



**Përqindja e fondeve burimore në pjesëmarrjen e buxhetit Komunal të aprovuar në fillim viti :**

- Grandi qeveritarë në shumë 17,283,039.00 € merr pjesë me 88.50 % të Buxhetit Komunal,
- Të hyrat komunale në shumë 1,643,620.32 € marrin pjesë me 8.42 %, dhe
- Donacionet (DEMOS-i) në shumë 603,119.51 € merr pjesë me 3.09 %.

**3. TË HYRAT VETANAKE JANAR-SHTATOR 2024**

Përveç granteve të pranuar me grantet specifike, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka arkëtuar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: tatimin në pronë, gjobat e trafikut, taksa administrative për leje ndërtimi, të hyrat nga koncesionet, shërbimet e kadastrave, taksa për regjistrimin e automjeteve etj. të cilat kanë rendësi të madhe për buxhetin e përgjithshëm komunal . Të hyrat janar-shtator 2024 të arkëtuara kanë arritur në shumën prej 1,219,302.83 € që tregon një realizim prej 93.85 % të planifikimit vjetor, kurse në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023 janë për 27.62 % më të ulëta..

Te hyrat që janë të arkëtuara nga Komuna të cilat marrin pjesë me përqindjen më të madhe edhe me tej janë: të hyrat nga lejet e ndërtimit 33.65 %, tatimi në pronë 12.63 %, koncesionet 4.34 % , shfrytëzimi i pronës publike 5.31 % etj.

Detajet e të arkëtuarave në shumën shih tabelën në vijim nr.2

**Te hyrat Vetanake komunale - Janar-shtator 2024**

TABELA NR. 2

## PASQYRA

e të hyrave vetanake sipas drejtorive, planifikuar dhe realizuar në periudhën: Janar - Shtator 2024

Nr.	Përshkrimi	Kodi	Planifikimi		Realizimi		% e planit
			2024	2024	2023	5/4	
1	2	3	4	5	6	7	
I	Administrata dhe personeli	16323	56,550.00	38,552.04	45,788.85	68.17	
1	Çertifikatë lindjeje	50013	2,700.00	2,897.92	2,804.00	107.33	
2	Çertifikatë kurorëzimi	50014	7,600.00	2,782.00	2,731.00	36.61	
3	Çertifikatë vdekjeje	50015	2,800.00	1,471.00	2,036.00	52.54	
4	Çertifikatë - vërtetime të tjera ofiqarike	50016	40,450.00	30,148.00	36,059.00	74.53	
5	Taksa administrative	50019	3,000.00	687.00	904.30	22.90	
6	Sigurimi i automjeteve	50109		48.60	1,254.55		
7	Shitja e pasurisë komunale	50413		517.52	-		
II	Inspektimi	16645	5,800.00	7,735.00	4,800.00	133.36	
1	Gjobat nga inspektorët komunal	50104	3,000.00	6,825.00	3,800.00	227.50	
2	Gjobat mandatore - hudhja e	50114	800.00	-	-	-	
3	Taksa për pranimit teknik të lokaleve	50205	2,000.00	910.00	1,000.00	45.50	
III	Buxhet e Financë	17523	466,945.00	234,694.57	412,073.32	50.26	
1	Tatimi në pronë	40110	377,870.00	154,017.57	337,538.81	40.76	
2	Taksa për regjistrimin e automjeteve	50001	87,500.00	78,596.00	70,911.50	89.82	
3	Taksa për regjistrimin e trashigimisë	50019	30.00	-	-	-	
4	Taksat për vërtetime dhe çertifikata	50011	1,545.00	1,280.00	2,191.00	82.85	
5	Taks Administrative	50019		801.00	1,432.01		
IV	Zhvillimi Ekonomik - Planifikimi	48023	28,000.00	17,745.00	18,300.00	63.38	
5	Taksa komunale në biznes	50201	28,000.00	17,745.00	18,300.00	63.38	
IV	Shërbimet Publike e Mbrojtja Civile	18023	-	5,008.60	565.00		
1	Taksa për leje parkingu	50008		4,110.00	315.00		
5	Shfrytëzim i pronës publike	50405		898.60	250.00		
V	Bujqësi dhe zhvillim rural	47023	32,380.00	9,181.05	11,698.94	28.35	
1	Ndërrimi i destinimit të tokës	50012	180.00	-	-		
2	Taksa tjera administrative për bujqësi	50016	1,200.00	181.00	5,504.56	15.08	
4	Participimet në bujqësi	50409	31,000.00	9,000.05	6,194.38	29.03	
VII	Gjeodezia, Kadastrri dhe Prona	65315	111,500.00	181,229.42	217,619.08	162.54	
1	Trashigimia - bartja, regjistrimi i pronës	50011	45,000.00	27,757.00	46,631.00	61.68	
3	Taksë për fletë-poseduese dhe kopje	50032	12,000.00	10,711.00	10,602.00	89.26	
4	Taksa administrative	50019		3,505.00	5,338.00		
5	Renta - shfrytëzimi i pronës publike	50405	12,500.00	64,769.15	21,605.00	518.15	
6	Qiraja nga objektet publike	50408	20,000.00	14,444.44	15,396.25	72.22	
7	Aktivitetet në terren për matje	50504	22,000.00	26,688.00	23,531.00	121.31	
8	Tax. ndërrim destinimit tokës	50012		33,354.83	94,515.83		
VIII	Urbanizmi dhe Mbrojtja e Ambientit	66620	364,868.00	535,024.65	666,654.10	146.64	
1	Lejet ndërtimore	50009	203,868.00	410,241.17	436,438.87	201.23	
2	Taksat administrative	50019		1,400.00	1,790.00		
3	Të hyrat nga koncesioni	50417	121,000.00	52,891.60	188,884.60	43.71	
4	Takse komunale për leje mjedisi	50045	20,000.00	52,483.04	39,311.86	262.42	
0	Legalizimi i Objekteve Ndërtimore	50026	20,000.00	18,008.84	228.77	90.04	
IX	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	73032	16,000.00	13,186.00	12,145.00	82.41	
1	Taksa administrative DSHMS	50019	16,000.00	13,186.00	12,145.00	82.41	
a	Shtëpia e shëndetit OKMF	74400	22,400.00	28,253.50	23,341.00	150.28	
1	Participimi - arka	50409	18,900.00	24,668.50	19,966.00	161.23	
2	Çertifikatë mjeku	50024	3,500.00	3,585.00	3,375.00	102.43	
XI	Kultura, Rinia e Sporti	85023	2,680.00	20.00	40.00	0.75	
1	Qiraja nga objektet publike	50408	1,450.00	-	-	-	
2	Participimi nga KRS (biblioteka)	50409	1,230.00	20.00	40.00	1.63	
XII	Arsimi - qerdhja e fëmijëve	92650	57,000.00	36,153.00	29,520.00	63.43	
3	Participimi për kujdesin e fëmijëve	50409	55,000.00	36,153.00	29,520.00	65.73	
4	Participimi për kujdesin e fëmijëve-Bajë	50409	2,000.00	-	-	-	
	<b>GJITHSEJ TE HYRAT</b>		<b>1,164,123.00</b>	<b>1,106,782.83</b>	<b>1,442,545.29</b>	<b>95.07</b>	
	<i>Te Hyrat tjera - Gjobat nga Trafiku, Gjykata, e tjera</i>		135,148.00	112,520.00	113,486.00	83.26	
1	Të hyrat nga gjobat në trafik	50101	110,000.00	92,625.00	90,261.00	84.20	
2	Të hyrat nga gjobat e gjykatave	50102	25,000.00	19,820.00	23,180.00	79.28	
3	Të hyrat nga Agjensioni pyjor e tjera	50107	148.00	75.00	45.00	50.68	
	<b>GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE</b>		<b>1,299,271.00</b>	<b>1,219,302.83</b>	<b>1,556,031.29</b>	<b>93.85</b>	

#### 4. SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet e komunës janë realizuar përmes pesë kategorive ekonomike të parapara me Ligjin e buxhetit për vitin 2024 dhe atë për :

- Paga dhe shtesa
- Mallra dhe shërbime
- Shërbime komunale
- Subvencione dhe
- Shpenzime kapitale

Në tabelën vijuese kemi paraqitur të dhënat për lëvizjen e të gjitha këtyre kategorive të shpenzimeve për periudhën raportuese janar-shtator 2024 duke krahasuar shpenzimet e kësaj periudhe me shpenzimet e periudhës së njëjta të vitit 2023 dhe 2022 si dhe pjesëmarrjen e kategorive të veçanta të tyre në shpenzimet e gjithmbarshme komunale për vitin fiskal 2024.

Sipas tabelës mund të shihet se:

- **Pagat dhe shtesat** kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2023 për 26.55 % , dhe një rritje të tillë është e ndikuar nga vendimet gjyqësore/përmbartimore , pjesëmarrja e pagave në shpenzimet e përgjithshëm komunale për periudhën janar- shtator 2024 është 56.13 %
- **Mallrat dhe shërbimet** kanë pasur rritje prej 22.62 % në krahasim me vitin 2023, kurse pjesëmarrja e tyre në shpenzimet e përgjithshme është 11.28 %.

**Rënie të konsiderueshme ka pas te nënkategoria:**

mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, furnizime për zyre, kompensimi i përfaq. brenda vendit etj.

**Rritje të konsiderueshme ka pasur të nënkategoria:** mirëmbajtja e ndërtesave arsimore, mirëmbajtja e objekteve shëndetësore, drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje por edhe ndikimi nga vendimet gjyqësore/ përmbartimore.

- **Shërbimet komunale** kanë pësuar rritje prej 3.82 % , kurse në shpenzimet e përgjithshme marrin pjesë me 1.37 %
- **Subvencionet** dhe transferet kanë shënuar rritje prej 26.33 % , janë subvencionuar kryesisht programet për bujqësi, pagesa të këtij viti për Bashkësinë Islame, pagesa për fëmijët e porsalindur, raste të trajtimeve shëndetësore, financimi i bursave për studente, përkrahja në fushën e kulturës rinise dhe sportit (mbësh. e klubeve sportive), përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme me grante sipas planeve të tyre biznesore. etj. Në shpenzimet e përgjithshme subvencionet marrin pjesë me 5.59 %
- **Shpenzimet Kapitale** kanë shënuar rritje për 54.69 % , ndërsa në shpenzimet e përgjithshme komunale marrin pjesë më 25.63 %

Në përgjithësi shpenzimet e gjithmbarshme komunale janar-shtator 2024 janë për 27.56 % më të larta se ato për periudhën e njëjta në vitin 2023.

Në shpenzimin e buxhetit për periudhën raportuese ka përfitua edhe gjinia femërore neper te gjitha kategoritë.

Për më tepër të dhënat në tabelën nr.3:

#### Tabela nr. 3 Analatika e shpenzimit të buxhetit

Nr. R	LLOJI I SHPENZIMEVE	Kodi ekonomik	Shpenzimi sipas viteve :		
			2022	2023	2024
1	Paga Neto	11111	4,728,507.47	6,118,115.49	6,068,756.09
2	Tatimi në të ardhurat personale	11121	273,584.96	392,458.90	416,969.59
3	Kontributi pensional -Punëtori	11131	262,417.21	343,484.78	365,988.25
4	Sindikatat	11151	21,862.34	13,398.06	14,963.40
5	Oda Profesionale	11152	4,449.80	4,443.41	5,608.98
6	Përvoja e punës	11211			299,196.41
7	Kontributi pensional -Punëdhënësi	11311	262,417.21	343,397.17	365,988.45
8	Shtesat e veqanta për të zgjedhurit	11411			23,523.72
9	Kujdestaria,puna gjatë natës,Puna jashtë orarit të punës	11431			127,383.07
10	Shtesat tranzitore	11611			10,517.26
11	Vendimet gjyqësore	11900			1,455,619.83
<b>GJITHSEJ PAGAT</b>			<b>5,553,238.99</b>	<b>7,215,297.81</b>	<b>9,154,515.05</b>
1	Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendi	13140	592.00	6,653.00	933.00
2	Para xhepi /Meditje për udhëtim jashtë vendit	13141	180.00	564.80	104.00
3	Akomodimi-Udhëtimet zyrtare jashtë vendi	13142		2,308.90	2,333.32
4	Shpenzimet tjera për udhëtimet zyrtare jashtë vendi	13143		2,062.00	3,888.90
5	Shpenzimet të internetit	13310	1,410.91	5,381.40	6,888.60
6	Telefonia mobile	13320	10,029.90	13,594.00	13,110.40
7	Shpenzime postare	13330	6,846.07	6,681.60	5,006.61
8	Shërbimet e arsimit/trajnitimit	13410		5,000.00	10,500.00
9	Sherbime të ndryshme intelektuale dhe keshilldhense	13440	7,033.75	2,750.00	12,417.10
10	Shërbimet e veqanta -Konsulentë dhe Kontraktorë individual	13445			5,970.10
11	Sherbimet shtypjes /Printim	13450	16,023.29	37,762.04	45,198.47
12	Sherbime kontraktuese tjera	13460	413,802.16	576,119.62	274,028.13
13	Sherbime teknike	13470	9,562.08	21,225.99	20,994.22
14	Softuerët- Licencat dhe mirëmbajtja e tyre	13471			4,800.00
15	Sigurimi fizik i objekteve publike	13475			110,105.28
16	Shpenzimet për anëtarësim	13480	14,628.70	14,628.70	14,628.70
17	Mobilje më pak se 1000 euro	13501	4,837.99	5,484.31	30,733.79
18	Kompiutera me pak se 1000	13503		73,673.80	3,812.50
19	Hardwer për teknologji informative <1000	13504		957.20	-
20	Makinat fotokopieuse -multifunksionale	13505			980.00
21	Paisje speciale mjeksore (me pak se 1000 euro )	13506			849.96
22	Paisje tjera	13509	19,968.05	2,429.96	6,364.09
23	Furnizime per zyre	13610	20,165.60	70,074.31	56,379.44
24	Dokumenta Blanko	13611		16,040.00	7,413.90
25	Furnizim me ushqim dhe pije ( jo dreka zyrtare)	13620	23,746.94	29,034.69	71,666.15
26	Furnizime mjeksore	13630	29,016.01	53,458.15	20,367.11
27	Furnizim pastrimi	13640	25,672.85	19,439.06	28,170.75
28	Vajëra	13710		5,067.00	478.75
29	Naft per ngrohje qendrore	13720	24,650.49	21,570.92	25,348.64
30	Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	13760	60,035.00	78,478.00	126,630.00
31	Derivate per Gjenerator	13770	777.80	1,753.95	-
32	Derivate per automjete	13780	61,261.17	60,915.88	64,544.50
33	Avancë-për udhëtime zyrtare	13820			512.50
34	Rexhistrimi i automjeteve	13950	4,595.00	5,094.00	3,822.00
35	Sigurim i automjeteve	13951	8,751.47	8,751.47	9,997.08
36	Kontrollim teknik i automjeteve	13954			550.00
37	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	14010	18,180.00	41,158.22	23,122.20
38	Mirëmbajtja dhe riparim i ndërtesave	14020	794.99		-
39	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste	14022	2,464.72	7,906.95	57,990.76
40	Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	14023	54,402.74	53,991.88	209,955.19
41	Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	14024	387.31	385.60	52,368.54
42	Mirëmbajtja e objekteve sportive	14026			1,500.00
43	Mirëmbajtja e objekteve kulturore	14027			1,500.00
44	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	14032	194,166.13	179,184.26	176,882.67
45	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	14040	1,129.00	305.00	-
46	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve	14050	37,491.40	39,286.04	86,721.00
47	Mirëmbajtja rutinore	14060			108,330.57
48	Qiraja për makineri	14140		1,237.50	-
49	Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	14310	20,831.00	28,434.94	22,743.40
50	Vendimet gjyqësore	14410		880.30	108,261.48
<b>MALLËRA DHE SHËRBIME</b>			<b>1,093,434.52</b>	<b>1,499,725.44</b>	<b>1,838,903.80</b>



**Vazhdim i tabelës nr. 3**

1	Energjia elektrike	13210	105,087.28	152,830.55	135,336.68
2	Shërbimet e ujësjellsit dhe kanalizimit	13220	34,001.13	33,303.20	27,083.20
3	Mbeturinat	13230	17,129.98	26,907.64	36,475.90
4	Telefonia fikse	13250	1,261.09	2,167.58	1,480.53
5	Pagesat- Vendimet gjyqësore	13260			23,092.31
	<b>SHPENZIME TE KOMUNALIVE</b>		<b>157,479.48</b>	<b>215,208.97</b>	<b>223,468.62</b>
1	Subvencione për Entitete Jo Publike	21200	397,750.46	974,191.60	429,251.60
2	Transferet për përfitues individual tjerë	22202	185,738.31	159,900.00	372,745.80
3	Pagesa për shërbimet e varrimit	22298			65,800.00
4	Qiraja për raste sociale	22299			5,610.00
5	Vendimet gjyqësore	22300			38,235.15
	<b>SUBVENCIONE</b>		<b>583,488.77</b>	<b>1,134,091.60</b>	<b>911,642.55</b>

TABELA NR. 4 INVESTIMET KAPITALE Janar - shtator 2024

643 SKENDERAJ		Buxheti i shpënuarë		Totali i shpënuar	% e realizuar.	
Kodi i proj.	Emertimi i projekteve	Buxheti i planifikuar	Shpenzuar sipas planit			Shpenzuar me vend/gjygjës.
54307	Ndriçimi publik në fshatra Abria e Poshmë, Aqareva, Baja, Baksi, Buroja, Çirezi, Çitaku, Çubrelli, Dasheci, Izbia, Klina e Epërme, Klina e Mesme, Klina e Poshtme, Klladërnica, Kopiliq	131,925.55	50,000.00		50,000.00	37.90
52568	Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 -Prekaz	35,000.00	35,000.00		35,000.00	100.00
51596	Asfaltimi i rrugës Rakincë-Qubrel	36,354.00	36,350.36		36,350.36	99.99
54315	Asfaltimi i rrugës Runik te Kisha	11,215.00	-	11,205.00	11,205.00	99.91
54316	Asfaltimi i rrugës Skenderaj-Vushtrri	14,500.00	14,500.00		14,500.00	100.00
51209	Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i lumenjve në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turiquevc, Polac, Qirez, Runik, Likoc, Rezallë	173,000.00	117,423.05	7,359.76	124,782.81	72.13
54329	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Izbicë-faza 2	47,074.45	47,074.00		47,074.00	100.00
54281	Asfaltimi i rrugëve në fshatrat; Kuqicë, Qubrel, Kasterc, Vitak, Klladërnica, Burojë, Vajnik, Abri, Tie, Klinë , Prekaz	95,880.00	-		-	-
54005	Asfaltimi, riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në BL Likoc, Turiquevc, Runik, Qirez	145,000.00	145,000.00		145,000.00	100.00
43870	Fondi i bashkëfinancimit (BBF-ja)	240,000.00	158,806.90	30,831.96	189,638.86	79.02
52596	Blerja dhe mirëmbajtja e kamerave te hapësirave publike në: Rr. "Ilaz Kodra", "28 Nëntori", "Ali Gashi", "Rr Osman Geci", parkun "Idriz Recci" dhe parkun "Amerikan".	15,000.00	1,017.00		1,017.00	6.78
54252	Blerja e aparatit fotografik profesional	6,000.00	-		-	-
52597	Blerja e pajisjeve motorike për pastrimin e qytetit	50,000.00	-		-	-
52609	Digitalizimi i shkollave Abedin Rexha Turiquevc, Dëshmoret e Qiqavicës Qirez, Shote Galica Runik, Fehmi Rama Likoc, Azem Bejta Prekaz, Malush Ahmeti Rezallë, Elena Gjika Makemal, Enver Haliti	40,000.00	-	40,000.00	40,000.00	100.00
55170	Furnizimi me kabinate dhe laboratore te Shkollave SHFMU "Shaban Jashari", SHFMU " Halit Geci", SHFMU " Skender Skenderi" dhe IAAP "Anton Çetta"	75,000.00	74,976.50		74,976.50	99.97
52602	Blerja e tabelave interaktive - digjitale në SHFMU Shaban Jashari, Ahmet Delia, Hamez Jashari dhe Anton Çetta	15,000.00	14,985.00		14,985.00	99.90
50808	Kanalizimi ne fashtra BL Turiquevc faza-III	30,000.00	30,000.00		30,000.00	100.00
46418	Kanalizimi ne BL Qirez	95,000.00	94,992.21		94,992.21	99.99
50056	Kanalizimi fekal Syrganë - Bajë	15,000.00	15,000.00		15,000.00	100.00
90313	Kanalizimi fekal ne fshatin Kline e Ulet	70,000.00	70,000.00		70,000.00	100.00
50813	Kanalizimi ne BL-Likoc faza III(Abri dhe Murqë)	85,000.00	32,956.78	30,000.00	62,956.78	74.07
44816	Kanalizimi në BL-Likoc	23,638.75	12,139.82	2,001.38	14,141.20	59.82
52605	Ndërtimi i këndeve për lojëra në shkollat: Shaban Jashari Skenderaj, Ahmet Delija Skenderaj, Abedin Rexha Turiquevc, Dëshmoret e Qiqavicës Qirez, Shote Galica Runik, Fehmi Rama Likoc, Azem Bejta	20,000.00	20,000.00		20,000.00	100.00
54311	Asfaltimi i rrugës Kotor-Qubrel	16,624.00	16,624.00		16,624.00	100.00
